



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE
KULLOTAVE TË EKONOMISË PYJORE “PRUEMOS SHELDI” BASHKIA
SHKODËR”.**

Konsultim publik : Njësia administrative Gur i zi.

Data : 16.11.2023

Ora : 13:00

Vendi: Qendra komunitare

Numri i pjesëmarrësve : Numri i pjesëmarrësve 10, nga të cilat 1 grua, dhe 9 burra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore "Pruemos Sheldi".

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Znj.Shllaku**, drejtore e drejtorisë së mjedisit në Bashkinë Shkodër , e cila relaton sipas materialit të përgatitur nga specialistë të administratës.

Vijon **Z.Haxhia**, cili shprehet se i duhet dhënë prioritet turizmit në këtë zonë. Pasi nëse jepet me qira mund të behet pengesë . Ai shton se pyjet në njësinë administrative Gur i zi nuk janë prerë shumë por kanë gjithsesi nevojë që të ruhen.

Në fshatin Rragam është bërë një lokal pranë liqenit, i cili po shërben si atraksion për zonën prandaj duhet vëmendje e shtuar.

Znj.Shllaku përgjigjet se është parashikuar që për pjesa e liqenit të ofrohet për agroturizëm.

Z.Brahimaj pyet se përse është zgjedhur pikërisht kjo zonë për planin?

Përsëri përgjigjet **Znj.Shllaku** e cila thotë zgjedhja është bërë pasi zona ka potencial, ka numër të konsiderueshëm banorësh dhe është e përshtatshme. Ajo shton për më tepër këtë vit kemi parashikuar fond edhe për zonën Rasek-Drisht.

Z.Bahri Osmani shprehet se pavarësisht banorëve , duhet të kemi mbështetje në mirëmbajtje.

Znj.Shllaku shprehet se Bashkia Shkodër ka vendosur një mirëmbajtës që është specialist i fushës, teknik pyjesh.

Banor- fshati Sheldi shprehet se kemi sipërfaqe të madhe pyjesh në zonën tonë dhe duhet kujdes i veçantë. Gjithashtu ai thotë se kemi vende shumë të bukura, me potencial për turizëm prandaj nuk duhet të lihem i harresë.

Përsëri **Z.Haxhija**, i cili thotë se tekniku i pyjeve duhet të kontrollojë edhe për shkelje dhe abuzime të ndryshme, pasi shpesh herë janë evidentuar raste për procedim nga policia. Po ashtu ai pyet po zona e Vukatanës a është parashikuar të ketë pyllëzim.

Përgjigjet **Z.Shllaku**, se Vukatana është ekonomi pyjore tjetër dhe nuk ka plan për këtë.

Z.Haxhiraj pyet në lidhje me 500 m² dru që nuk rriten në zonën e Sheldisë, si mund të merret leje për shitjen e tyre në treg.

Znj.Shllaku thotë se shitja nuk lejohet. Këtë të drejtë e ka vetëm Bashkia por nëse e kërkon këtë leje për vehten tuaj ka procedurë tjetër. Për më tepër informacion mund të drejtoheni në Bashkinë Shkodër, ku mund të merrni sqarim më të detajuar.


Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka kryetari i keshillit bashkiak falenderon të pranishmit dhe deklaron të mbyllur takimin.

SEKRETAR


Denis LESHJA

Zbardhi process verbalin :



Irma Sulishti



DEGJESE PUBLIKE BASHKIA SHKODER

“ Për miratimin e planit të mbarrështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore “ Pruenos Sheldi”, Bashkia Shkoder.

LISTE PREZENCE

Nr.	Emri Mbiemri	FSHATI	Kontakt	e-mail	Firma
1	Noter Polena	Milhem	0692458744	milhem.1624@gmail.com	
2	Kushijon	Simoni	0692806912	simoni.kushijon@gmail.com	
3	Folena Kodari	Doni D.	0673708623	—	
4	Bohor Osmani	Udhëtar	0675582324	—	
5	Bohor Osmani	gjuzi	0693317812	—	
6	Metë Shkoder	Sheldi	0682184464	—	
7	Grifit	Viktor	06733834530	—	
8	Bledar	Brakimatos (Postribë)	0684142631	—	
9	Greim Mery	Postribë	0685172423	greim.mery@gmail.com	